REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"

Konsultim publik : Lagjia nr.3.

Data : *24.09.2026* **Ora** : *13.00* **Vendi:** *Salla e Këshillit Bashkiak.*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesmarrësve 19, nga të cilat 4 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2027-2029 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Bekim Mema, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

I. Paraqitja e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektbuxhetit

Takimi u hap nga **Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Bekim Mema,** i cili ftoi banorët të paraqisnin problematikat dhe propozimet e tyre dhe të përcaktonin prioritetet që, sipas nevojave të komunitetit, duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit të buxhetit të vitit 2027 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.

Pjesëmarrësit u ftuan të fokusoheshin në nevojat që lidhen me funksionet dhe shërbimet e Bashkisë Shkodër, përfshirë infrastrukturën rrugore, ujësjellës-kanalizimet, ndriçimin publik, pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve, hapësirat publike, transportin, arsimin dhe nevoja të tjera të komunitetit.

II. Diskutimet, kërkesat dhe propozimet

Z. Andrea Darragjati, banor i lagjes Gjuhadol: Ngriti problematikën e sinjalistikës në rrugën "Luigj Gurakuqi", mungesën e mundësive për parkim pranë banesave dhe shqetësimet nga zhurmat e lokaleve që shfrytëzojnë hapësirat publike. Evidentoi se pistonat e vendosur krijojnë vështirësi për aksesin e banorëve.

Z. Anton Mala, banor i rrugës së Gurakuqve: Kërkoi zgjidhje për parkimin e rezidentëve pranë banesave dhe riparimin e pllakave të dëmtuara në zonë.

Z. Jozef Bazhdari, banor i lagjes Luigj Gurakuqi: Sqaroi se banorët kishin paraqitur kërkesë me shkrim dhe prisnin përgjigje zyrtare. Kërkoi që ndërhyrjet në zonë të bëhen në konsultim me banorët. Propozoi përdorimin e telekamerave inteligjente dhe pajisjen e rezidentëve me karta ose autorizime që u mundësojnë akses dhe parkim pranë banesave. Shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me Bashkinë për një zgjidhje të përbashkët.

Z. Kujtim Haxhija, banor i lagjes Luigj Gurakuqi: Ngriti mospërputhjen ndërmjet sinjalistikës dhe mënyrës së parkimit, duke evidentuar raste gjobash pa një njoftim paraprak të banorëve. Kërkoi rishikimin e sensit të qarkullimit në rrugën "Ludovig Saraçi", garantimin e aksesit në banesa, lirimin e hapësirave për kalimin me karroca, zgjidhjen e aksesit për ambulancat dhe parkim për rezidentët. Kërkoi gjithashtu rishikimin e gjobave dhe riparimin e pllakave të amortizuara.

Z. Salvator Kurti, banor i lagjes së Gurakuqve: Kërkoi sqarim për bazën e vendimmarrjes që lidhet me qarkullimin dhe parkimin në zonë. Propozoi buxhetimin e telekamerave inteligjente si zgjidhje për kontrollin e aksesit. Kërkoi gjithashtu organizimin e mbledhjes së mbetjeve derë më derë dhe shqyrtimin e mundësisë për parkim në njërin krah të rrugës "Ludovig Saraçi".

Z. Berti Ashta, banor i rrugës Loro Kovaçi: Ngriti problematikën e organizimit të hapësirës ndërmjet kazanëve të mbetjeve dhe parkimit, si dhe kërkoi vëmendje më të madhe nga Policia Bashkiake për këtë rrugë.

Znj. Majlinda Kalaj, banore e Rajonit nr. 3: Kërkoi përfshirjen në buxhet të rrugës "Fili Parruca", rreth 200-250 m, ku ka mbi 30 banesa. Sipas saj, rruga është e dëmtuar dhe e amortizuar dhe gjatë reshjeve bëhet e vështirë për t'u kaluar.

III. Evidentimi i prioriteteve dhe dokumentacioni

1. Zgjidhja e parkimit dhe aksesit për rezidentët e Gjuhadolit dhe zonës Luigj Gurakuqi, përfshirë mundësinë e kartave/autorizimeve të rezidentit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

KONSULTIM PUBLIK: ***" PËR DRAFT PROJEKT PLANIN BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"***

Lagjia nr.3 ***Datë: 24.09.2026***

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Noki Peshku	Skenderbeg	0693607077		
2.	Hajlinda Kalaj	Skenderbeg	0696986191		
3.	Salvator Vuri	Gjuhadol	0692050472		
4.	Gjon Afxhezeza	Gjuhadol	0674004063		
5.	Hasel Hysa	Gjuhadol	0692164648		
6.	Renato Meroshi	Spitalor	0696281324		
7.	Jul BRRAKA	Gurakuqe			
8.	Anton MALA	Gurakuqi			
9.	Najade Anameti	B. Shkodër	0673151619		

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
10.	Altin Shaqi	NSHPP	0672626866		
11.	Helia Sh.C.U.	NSHPP	0682042890		
12.	Ilir Shuka	DPMoP	0695411334		
13.	Aferdita Feiheki	B. Shkodër	0693493380		
14.	Xhelde Shehaj	Shkodër	0696284345	xhelde.shehaj@osfa.org.al	
15.	BERTI ASHTA	PERL. RRXHE	0692966232	ashta.berti@g.mail.com	
16.	Amelica Daragjati	Gjirokastër	0696784701		
17.	JOZEF BAZHDARI	rr Luigj Gurakuqi	0692031167	jbazhdari@gmail.com	
18.	Fatsel Furshaj				
19.	Kujtim Hoxhia	Rr. Luigj Gurakuqi	0696045602	kujtimhoxhia@gmail.com	
20					
21					
22					
23					
24					
25.					
26					
27					
28.					
29.					